

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE TREGTARE "S.O.S.Dial" SH.P.K**

Në Tiranë, sot me dt. 16.12.2022, referuar ligjit Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007, ndryshuar me Ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015 si dhe ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, unë Armando Ymeri, atësia Isuf , amësia Rezarta , shtetas Shqiptar, lindur me 09.02.1999, ne Kamez dhe banues ne Tirane, madhor e me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar, i identifikuar me Nr. Personal J90209034H, dhe Andi Bakiu, atësia Gezim, i datëlindjes 04.06.1989, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me letërnjoftim nr.personal I90604051G, me nënshkrimin e këtij akti për themelimin e shoqërisë tregtare "S.O.S.Dial" sh.p.k, marrim përsipër të realizojme e të respektojme të drejtat dhe detyrimet me precizitet e mëposhtme:

**NENI 1**

Krijohet shoqëria me përgjegjësi te kufizuar me emër "S.O.S.Dial" sh.p.k, e cila është një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, e te drejtës shqiptare me ortak shqiptar.

Selia e shoqërisë caktohet ne adrese: Rruga "29 Nentori",Kompleksi Fole (pranë Karburanti Bolv Oil) Laprake Tirane.

Shoqëria, me vendim te Asamblesë se Ortakeve, mund te vendose te krijoj filiale, dege, zyra, agjenci si dhe përfaqësi, ne bashkëpunim ose jo me shoqëri te vendit ose te huaja, xhoivencer me persona publike dhe fizike në Shqipëri ose jashtë saj.

**NENI 2**

Kohëzgjatja e shoqërisë caktohet pa afat te përcaktuar dhe fillon që nga data e regjistrimit të saj në QKB (Qendra Kombetare e Biznesit).

Kjo kohëzgjatje mund te ndryshohet me zgjatje te afatit apo shkurtim te tij me vendim te ortakut te vetëm për sa ky është i tillë ose me vendim te Asamblesë se Ortakeve kur numri i ortakeve rritet. Ne këtë raste votimi do te behet me shumice votash te cilën e cakton ligji.

**NENI 3**

Themeluesit e shoqërisë me këtë akt themelimi, marrin përsipër qe te respektojne te gjitha detyrimet qe parashikon legjislacioni tregtar e civil shqiptar për shoqëritë tregtare me përgjegjësi te kufizuar, si dhe ti përmbahet kriterit te respektimit te politikës tregtare qe zhvillohet sot ne Republikën e Shqipërisë.

**NENI 4**

Kapitali shoqërisë është 10.000 Leke (dhjete mije leke). I gjithë kapitali i shoqërisë do te zotërohet nga ortakët z.Armando Ymeri me 50% te kapitalit dhe z. Andi Bakiu me 50% te kapitalit .

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga dy kuota te barabarte me 10.000 Leke (dhjete mije leke) dhe eshte i përberë nga;

1. Kontribute kesh te ortakeve ne shumen 10 000 leke (dhjete mije leke) për shoqëri ne themelim e sipër.



Pavarësisht natyrës së kontributit, vlera e kuotave themeluese të shoqërisë janë të barasvlershme me njëra tjetrën. Kapitali i shoqërisë mund të rritet me depozitime të reja nga ortakët e saj, analogjikisht me ciklin e punëve të saj, ose mund të zvogëlohet sipas vendimit të Asamblesë së Ortakeve.

Raporti vlerësimit të ekspertit për vlerësimin e kontributeve në natyrë do të dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

#### **NENI 5**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: "Media Marketing, Suport Operativ, Shërbim Operativ, Marketing Online, Ofrimi i shërbimeve të trajnimit dhe konsultimi në çështje telekomunikacionit. Shoqëria mundet gjithashtu të ushtroje çdo lloj tjetër biznesi apo aktiviteti të ligjshëm dhe/ose mund të angazhohet në çdo veprimtari të ligjshme ose aktivitet të lejueshëm nga legjislativi Shqiptar në fuqi .

#### **NENI 6**

Administrimi i çështjeve të Shoqërisë dhe përfaqësimi i saj i ngarkohet administratorit që është gjithmonë personi fizik i cili zgjidhen ose caktohen nga ortakët i vetëm themelues ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve nëse numri i tyre do të shtohet me vonë.

Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Si organ ekzekutiv i Shoqërisë, të drejtat dhe detyrat e administratorit, rregullohen me Aktet Themeluese të Shoqërisë, Statutin e Shoqërisë, ligjet përkatëse, si dhe me aktet e tjera normative të nxjerra nga Asambleja e Ortakeve apo dhe me marrëveshje të veçanta.

Administratori i shoqërisë emërohet z. Armando Ymeri, i datëlindjes 09.02.1999, banues në Tiranë mbajtës i letërnjoftimit ID Nr.J90209034H.

#### **NENI 7**

Kjo Kontrate Themelimi hartohet në Tiranë në 5 ekzemplare origjinale, duke pasur secila nga kopjet vlerë të barabartë ligjore e kuptimore.

#### **NENI 8**

Ortakët themelues, deklarojnë se njohin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ky Akt-Themelues dhe me vullnet të lirë e firmosin atë në vlerën e kontratës së themelimit të shoqërisë.

### **ORTAKËT THEMELUES TE SHOQËRISË TREGTARE "S.O.S.Dial" sh.p.k**

**z. Armando Isuf Ymeri**

Armando Ymeri  


**z. Andi Gezim Bakiu**

ANDI BAKIU  
